

URDHËR
Nr. 7, datë 23.1.2019

PËR ZGJATJEN E VLEFSHMËRISË
SË KARTËS SË INSPEKTORIT EDHE GJATË VITIT 2019, DERI NË
RISTRUKTURIMIN E INSPEKTORATEVE

Në zbatim të pikës 4, të nenit 30, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, kreut V, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik ‘e-Inspektimi’”,

URDHËROJ:

1. Zgjatjen e vlefshmërisë së kartës së inspektorit, të prodhuar sipas urdhrit nr. 32/1, datë 15.7.2016, me periudhë vlefshmërie deri më 31.12.2018 edhe gjatë vitit kalendarik 2019, deri në ristrukturimin e inspektorateve.
2. Për çdo emërim të ri në detyrë, inspektori do të pajiset me kartën e inspektorit pranë Inspektoratit Qendror.
3. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe inspektoratet shtetërore për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al, si dhe u njoftohet inspektorateve shtetërore.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari